



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA PEQIN

.Nr. \_\_\_\_.prot.

Peqin, më 18/09/2024

Shtojca 12 [Shtojcë për tu plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor]

**FORMULARI I NJOFTIMIT TË FITUESIT (PARAPRAK)**

Data 18.09.2024

*Drejtuar:* BOE “ASI-2A CO” shpk e regjistruar ne QKB me NIPT K53002402C, me adrese Fier, Rruga Skenderbeu, Lagjja Bishanake, Pallati Nr.18, Hyrja Nr.6, e perfaqesuar nga administratori i pergjithshem Z.Astrit Gjikonadaj  
“Shendelli” sh.p.k e regjistruar ne QKB me NIPT K07924803N me adrese Fier, Lagjja"Kastrioti", rruga "Andon Profka", 2 kullat Fier e perfaqesuar nga administratori i pergjithshem Z. Yzedin Bozh.

Procedura e prokurimit/lotit: Proçedure e Hapur - Pune

Numri i procedurës / referenca e Lotit: REF-16699-08-21-2024

Përshkrimi i shkurtër i kontratës:“ **Ndërhyrje Emergjente në Argjinaturën e Lumit Shkumbin për shmangien e shembjes së rrugës Cengelaj - Shezë, Bashkia Peqin** ”, me fond limit 49.691.349,00 ( dyzet e nente milion e gjashtëqind e nentedhjetë e një mijë e treqind e dyzet e nente ) leke pa tvsh. vënë në dispozicion nga buxheti i Shteti , me kohëzgjatje 45 dite nga nënshkrimi i Kontratës.

Publikimet e mëparshme (nëse është rasti): Buletini i Njoftimeve Publike [Data] [Numri]

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit:

oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar ne kosto

oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në çmim X

Me anë të këtij Njoftimi ju informojmë se, në këtë procedurë kanë marrë pjesë Ofertuesit e mëposhtëm me këto vlera përkatëse të ofruara:

1. BOE “ASI-2A CO” shpk & Shendelli” sh.p.k K53002402C, K07924803N

Emri i plotë i shoqërisë

Numri i NIPT-it

Vlera 48 179 355 ( dyzet e tetë milion e njëqind e shtatëdhjetë e nëntë mijë e treqind e pesëdhjetë e pesë ) lekë;

2. BOE "LLAZO" sh.p.k & VIANTE KONSTRUKSION sh.p.k & LIS KONSTRUKSION sh.p.k  
K24218401K, K47103804L, K66613407H

Emri i plotë i shoqërisë

Numri i NIPT-it

Vlera 37 308 306 (Tridhjetë e shtatë milion , e treqind e tete mijë e treqind e gjashtë Lekë )

3. BOE "LLUCA" sh.p.k & T&J Construction sh.p.k K29824105N, M29718101T

Emri i plotë i shoqërisë

Numri i NIPT-it

Vlera 49 145 145 (dyzete nentemilion njeqindedyzetepesemije njeqinde dyzetepese leke)

**Nga pjesëmarrësit janë skualifikuar Ofertuesit e mëposhtëm:**

1. BOE "LLAZO" sh.p.k & VIANTE KONSTRUKSION sh.p.k & LIS KONSTRUKSION sh.p.k  
K24218401K, K47103804L, K66613407H

Emri i plotë i shoqërisë

Numri i NIPT-it

1. Bashkimi i operatoreve ekonomik "Llazo shpk & Viante Konstruksion shpk & Lis Konstruksion shpk" nuk plotesojne kriterin ligjore te delegimit te aktit te perfaqesimit nga ana e te perfaqesuarve, "Viante shpk & Lis Konstruksion shpk" ne favor te perfaqesuesit Llazo shpk .  
Deklarata e dates 07/09/2024 me emertim Deklarate Perfaqesimi eshte paraqitur ne kundershtin me nenin 64 te Kodit Civil ne fuqi i cili sanksionon se , "Me perfaqesimin një person (perfaqesuesi) kryen, brenda tagreve që i janë dhënë nga ligji, nga prokura ose nga gjykata, veprime juridike në emër e për llogari të një personi fizik ose juridik tjetër (i perfaqesuari)".  
Ne rastin konkret nga permbajtja e Deklarates se Perfaqesimit te dates 07.09.2024 rezulton se eshte leshuar nga persona te cilet nuk kane pasur tagrin ligjore te leshojne kete akt perfaqesimi pasi ne emer dhe llogari te te perfaqesuarit , "Viante shpk" ka firmosur dhe vulosur administratori ligjore i operatorit ekonomik , "Lis Konstruksion" shpk dhe anasjelltas ne emer dhe per llogari te kompanise Lis Konstruksion shpk ka firmozur dhe vulosur administratori ligjore i shoqerise Viante Konstruksion shpk. Bazuar ne nenin 92 pika a) te Kodit civil ne fuqi i cili sanksionon se , "Veprimet juridike të pavlefshme nuk krijojnë asnjë pasojë juridike. Të tilla janë ato që:  
a) vijjnë në kundërshtim me një dispozitë urdhëruese të ligjit;  
Ne rastin konkret ky veprim juridik , akti i perfaqesimit vjen ne kundershtim me nenin 64 te kodit civil i cili sanksionon se Me perfaqesimin një person (perfaqesuesi) kryen, brenda tagreve që i janë dhënë nga ligji, nga prokura ose nga gjykata, veprime juridike në emër e për llogari të një personi

fizik ose juridik tjetër (i përfaqësuari) . Duke qe se akti i perfaqesimit eshte leshuar nga persona te cilet nuk e kane tagrin ligjore ta bejne nje gje te tille bazuar ne nenin 92 te kodit civil, ky akt juridik eshte nul, i pavlefshem juridikisht dhe nuk i jep te drejte operatorit ekonomik “Llazo“ shpk te perfaqesoje operatoret ekonomik Viante Konstruksion shpk & Lis Konstruksion shpk ne proceduren e prokurimit objekt trajtimi administrativ.

2. Bashkimi i operatoreve ekonomik, “Llazo shpk & Viante Konstruksion shpk & Lis Konstruksion shpk" nuk plotesojne kriterin ligjore te hartimit te marreveshjes se bashkepunimit ndermjet operatoreve ekonomik ne perputhje me ligjin e prokurimit publik . Marreveshja e bashkepunimit ndermjet operatoreve ekonomike eshte nje marreveshje ku caktohet perfaqesuesi, perqindja e pjesemarrjes ne bashkim dhe elementet qe merr persiper te realizoje secili prej anetareve te bashkimit. Ne rastin konkret nga permbajtja e marreveshjes se bashkepunimit te shoqerive te dates 07/09/2024 rezulton se operatori ekonomik Llazo shpk ka marre persiper 71.32% te punimeve, Viante Konstruksion shpk ka marre persiper 15.63% te punimeve dhe Lis Konstruksion 13.04% te punimeve. Nga mbledhja aritmetike e perindjes se punimeve te cituara me siper rezulton se shuma totale e punimeve e marre persiper nga bashkimi operatoreve ekonomik eshte 99.99 % dhe jo 100% sic e kerkon ligjin per prokurimin publik dhe aktet ligjore ne zbatim . Per sa analizohet me siper rezulton se BOE Llazo shpk & Viante Konstruksion shpk & Lis Konstruksion shpk deklarojne se nuk merr persiper realizimin e 100% te punimeve te parashikuara per realizimin e objektit dhe nisur nga ky shkak kjo marreveshje bashkepunimi shkakton refuzim automatik te ofertes se paraqitur dhe konstatohet si absolutisht e pavlefshme.

3. BOE, “Llazo shpk & Viante Konstruksion shpk & Lis Konstruksion shpk" nuk plotesojne kriterin e vecante te kualifikimit pika 2.3.4 ne lidhje me disponimin ne licencen e shoqerise si drejtues teknik ne listepagesat e shoqerise per te pakten nje periudhe te 3 muajve te fundit nga zhvillimi i tenderit te stafit inxhinierik Inxhinier Gjeoteknik nje punonjes . Inxhinierja gjeoteknike Iselda Pupuleku e paraqitur nga operatori ekonomik, “Llazo" shpk sic pranon ai vete ne deklaraten e dates 09.09.2024 ka filluar pune me korrik 2024 prane shoqerise Llazo shpk. Qe te plotesohej kriteri i mesiperm duhej qe minimalisht te fillonte pune ne 1 Maj te vitit 2024 .

Ndersa Inxhinieri Gjeoteknik Ervin Vito i paraqitur nga Llazo shpk si i punesuar prane tyre deri ne korrik 2024 nuk ka patur cilesine e drejtuesit teknik dhe nuk ka qene perfshire ne licencen e shoqerise.

4. BOE Llazo shpk & Viante Konstruksion shpk & Lis Konstruksion shpk nuk plotesojne kriterin e vecante te kualifikimit pika 2.3.4 ne lidhje me disponimin ne licencen e shoqerise si drejtues teknik si dhe ne listepagesat e shoqerise per te pakten nje periudhe te 3 muajve te fundit nga zhvillimi i tenderit te stafit inxhinierik Inxhinier Agronom 1 (nje) punonjes .

5. Referuar preventivit te ndarjes se punimeve te paraqitur nga BOE Llazo shpk & Viante Konstruksion shpk & Lis Konstruksion shpk rezulton se operatori ekonomik Viante Konstruksion shpk ka marre persiper kryerjen e punimeve, “Gabiona me rrjete teli te zinguar e gure kave 1x1x2m" ne sasine 38 m<sup>3</sup>, nga 58m<sup>3</sup> qe eshte totali i punimeve te parashikuar ne preventiv..Referuar dokumentave standarte te tenderit per kryerjen e punimeve te sipercituar

kerkohen 6 gurepunues/guregdhendes. Ne formularin e vetdeklarimit te paraqitur nga operatori ekonomik Viante konstruksion shpk rezulton se per kryerjen e punimeve te sipercituara disponon 3 punonjes gurepunues/guregdhendes por nga ana tjetere ai ka marre persiper me teper 50% te punimeve, te cilat nuk mund te realizohen me numrin e punonjesve te mesiperme, pasi per te kryer punimet e mesiperme nevojiten 4 punonjes gurepunues/guregdhendes. Per sa pershkruam sa me siper OE Viante Konstruksion nuk ploteson kriterin e kapacitetit teknik per kryerjen e punimeve te mesiperme.

6. Referuar preventivit te ndarjes se punimeve te paraqitur nga BOE Llazo shpk & Viante Konstruksion shpk & Lis Konstruksion shpk rezulton se operatori ekonomik Viante Konstruksion shpk ka marre persiper kryerjen e punimeve, "Shpim me Sonda me UKS 1m, deri ne 20 m, ne toke zhavorre (H mes, pilote= ml) " ne sasine 340 ml, nga 680 ml qe eshte totali i punimeve te parashikuar ne preventiv. Referuar dokumentave standarte te tenderit per kryerjen e punimeve te sipercituar kerkohen 4 (kater) Automakiniste. Ne formularin e vetdeklarimit te paraqitur nga operatori ekonomik Viante konstruksion shpk rezulton se per kryerjen e punimeve te sipercituara disponon 1 (nje) automakinist por nga ana tjetere ai ka marre persiper 50% te punimeve te cilat nuk mund te realizohen me numrin e punonjesve te mesiperme, pasi per te kryer punimet e mesiperme nevojiten 2 (dy) automakiniste. Per sa pershkruam sa me siper OE Viante Konstruksion shpk nuk ploteson kriterin e kapacitetit teknik per kryerjen e punimeve te mesiperme.

7. Anetari i BOE, "Lis Konstruksion" shpk, nuk ka paraqitur numrin mesatar te punonjesve per periudhen e 3 muajve te fundit nga data e zhvillimit te tenderit, qe eshte periudha Maj-Qershor - Korrik, por ne kundersizim me kriteret e vecanta te kualifikimit ne lidhje me kapacitetin teknik ai ka paraqitur deklarate per muajt Prill-Maj-Qershor, fakt i cili perben mospermbushje kriteresh kualifikimi kapaciteti teknik .

8. Anetari i BOE Lis Konstruksion shpk nga verifikimi i formularit te vetedeklarimit rezulton se nuk disponon punonjes te kualifikuar te pajisur me certifikate si Ekspert per Vleresimin e Ndikimit ne Mjedis, fakt i cili perben mospermbushje te kriteret e vecanta te kualifikimit ne lidhje me kapacitetin teknik pika 2.3.5.a.

9. Anetari i BOE Lis Konstruksion shpk nga verifikimi i formularit te vetedeklarimit rezulton se nuk disponon pajisje dhe mjete te sigurimit teknik qe jane te domosdoshme per mbrojtjen e jetes dhe shendetit te punonjesve. Konkretisht rezulton se nuk disponon kokore, fikse zjarri, komplet te ndihmes se shpejte, jeleke pune, si dhe tabela paralajmeruese.

10. Referuar preventivit te ndarjes se punimeve te paraqitur nga BOE Llazo shpk & Viante Konstruksion shpk & Lis Konstruksion shpk rezulton se operatori ekonomik Lis Konstruksion shpk ka marre persiper kryerjen e punimeve Beton me cakull C-30/37, per pilotat dhe traret lidhese te tyre ne sasine 133.8 m3. Referuar dokumentave standarte te tenderit per kryerjen e punimeve te sipercituar kerkohet qe operatoret ekonomik te disponojne, "autobetoniere", te cilen referuar permbajtjes se formularit te vetedeklarimit te OE Lis Konstruksion shpk rezulton se nuk e disponon nje mjet te tille dhe per pasoje eshte ne pamundesi per te kryer punimet e sipercituara.

11. Referuar preventivit te ndarjes se punimeve te paraqitur nga BOE Llazo shpk & Viante

Konstruksion shpk & Lis Konstruksion shpk rezulton se operatori ekonomik Llazo shpk ka mare persiper kryerjen e 100% te punimeve te zerave Transport dheu, Mbushje me cakull, germim dheu, germim shkambi etj. Referuar dokumentave standarte te tenderit per kryerjen e punimeve te sipercituar kerkohet qe operatoret ekonomik te disponojne kamion me kapacitet mbajtes 10-12 ton cope 2, mjete te cilat referuar permbajtjes se formularit te vetedeklarimit te Llazo shpk rezulton se nuk disponon 2 (dy) mjete te tille dhe per pasoje eshte ne pamundesi per te kryer punimet e sipercituara.

12. . Referuar preventivit te ndarjes se punimeve te paraqitur nga BOE Llazo shpk & Viante Konstruksion shpk & Lis Konstruksion shpk rezulton se operatori ekonomik Lis Konstruksion shpk shpk ka mare persiper kryerjen e 7.9% te punimeve te zerit F.V. hekur betoni i zakonshem Ø 12mm. Referuar dokumentave standarte te tenderit per kryerjen e punimeve te sipercituar kerkohet qe operatoret ekonomik te disponojne 7 (shtate) punonjes hekurkthyes dhe nga perkthimi ne perqindje punimesh rezulton se OE Lis Konstruksion duhet te disponoje 2 (dy) punonje shekurkthyes per realizimin e 7.9 % te punimeve dhe per pasoje eshte ne pamundesi per te kryer punimet e sipercituara.

13. Anetari i BOE Llazo nga verifikimi i formularit te vetedeklarimit rezulton se nuk disponon pajisje te llojit Palankola sasia 50 m2. Referuar permbajtjes se formularit te vetedeklarimit te Llazo shpk rezulton se ai ka deklaruar se disponon pajisje Palankola por jo sasine e kerkuar nga Autoriteti Kontraktor.

14. Anetari i BOE Llazo nga verifikimi i formularit te vetedeklarimit rezulton se nuk disponon pajisje dhe mjete te sigurimit teknik qe jane te domosdoshme per mbrojtjen e jetes dhe shendetit te punonjesve. Referuar permbajtjes se formularit te vetedeklarimit rezulton se nuk disponon pajisje dhe mjete te sigurimit teknik qe jane te domosdoshme per mbrojtjen e jetes dhe shendetit te punonjesve. Konkreti shtrezulton se nuk disponon fikse zjarri, komplet te ndihmes se shpejte, jeleke pune, si dhe tabela paralajmeruese ne sasine e kerkuar nga autoriteti kontraktor.

15. Anetari i BOE Llazo shpk ne funksion te permbushjes se kriterit te disponimit te nje autorizimi nga prodhuesi distributori per mallrat bojra termoplastike (spray) shoqeruar me certifikate prodhuese ISO 9001-2015 te prodhuesit ka paraqitur nje kontrate furnizimi date 07/09/2024 me nr.2011 Rep dhe nr.1284 Kol me shoerisne I.D.K Konstruksion . Kesaj kontrate i ka bashkangjitur te perkthyer skeda teknike, rezultate testimi si dhe nje Certifikate ISO ne emer dhe per llogari te shoqerise Italiane Maric S.R.L. me seli ne Rome . Nga verifikimi i dokumentave te dorezuara nuk rezulton asnje autorizim distributori te leshuar nga shoqeria Maric s.r.l. te leshuar per shoqerine I.D.K. Konstruksion me nipt K51408016J, dhe per pasoje ky kriter konsiderohet e papermbushur.

16. Anetari i BOE Llazo shpk ne funksion te permbushjes se kriterit te disponimit te nje autorizimi nga prodhuesi distributori per mallrat Shtylle ndricimi te shoqeruar me autorizim prodhuesi, katalog si dhe certifikate konformiteti qe keto materiale te jene ne perputhje me direktiven e bashkimit europian 2006/95/EC : 2014/35/EU Per tensionin e Ulet ka paraqitur kontraten e dates 04/09/2024 te lidhur me shoqerine Sali Elektrik shpk me nr.K72217008P nipti. Kesaj kontrate i jane bashkangjitur ne gjuhen italiane dhe te paperkthyer ISO 9001:2015 te

prodhuesit, certifikata konformitetit si dhe katalogje ne gjuhen italiane, Referuar ndryshimeve ligjore qe ka pesuar VKM nr.285 date 19.05.2021 Per miratimin e rregullave te prokurimit publik percaktohet se :  
Nenin 24, ,“Operatorët ekonomikë mund të paraqesin ofertat e tyre në gjuhët shqip ose anglisht. Një ofertë është e kualifikueshme edhe nëse një pjesë e dokumentacionit të saj mund të jetë në gjuhën shqipe dhe një pjesë në gjuhën angleze.”.  
Nisur nga ky sanksionim ligjore dokumentat e sipercituara me siper jane te pavlefshme per legjislacionin e prokurimit publik ne shqiperi dhe per pasoje ky kriter konsiderohet e papermbushur .

**2. BOE “LLUCA” sh.p.k & T&J Construction sh.p.k K29824105N, M29718101T**

**Emri i plotë i shoqërisë**

**Numri i NIPT-it**

1. Bashkimi i operatoreve BOE “LLUCA” shpk & “T&J Construction” shpk nuk permbushin piken 2.3.2 te Kriteve te Vecanta te Kualifikimit pasi nuk disponon licencat per kategorite e meposhtme :

- N.P-11 (Ndërtime për nënstacione, kabinat e transformacionit linjat e T/N dhe tensionit të mesëm dhe shpërndarjen e energjisë.) Nivel i A
- N.P-9 (Punime dhe mrojtje lumre,) Nivel i A
- N.P-12 (Punime te inxhinjerise se mjedisit) Nivel i B
  
- N.S.-9 (Punime strukturore speciale,) Nivel i B
- N.S.-18 (Punime topogjeodezike,) Nivel i A
- N.S.-20 (Shpime gjeologo-inxhinier,) Nivel i A

2. Bashkimi i operatoreve BOE “LLUCA” shpk & “T&J Construction” shpk nuk plotesojne kriterin e vecante te kualifikimit pika 2.3.4 ne lidhje me disponimin ne licencen e shoqerise si drejtues teknik si dhe ne listepagesat e shoqerise per te pakten nje periudhe te 3 muajve te fundit nga zhvillimi i tenderit te stafit inxhinierik 1 (një) Inxhinier Topograf/Gjeodet/Markshejder.

3. Referuar pikes 2.3.11 te dokumentave standarte te tenderit , rezulton se Anetari “LLUCA” shpk nuk disponon mjetet e nevojshme per realizimin e kontrates pasi sipas formularit permbledhes te vetedeklarimit , nuk disponon Asfaltshtruese. Si pasoje Anetari “LLUCA” shpk eshte ne pamundesi per te realizuar punimet qe ka mare persiper.

\* \* \*

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë “BOE “ASI-2A CO” shpk e regjistruar ne QKB me NIPT K53002402C, me adrese Fier, Rruga Skenderbeu, Lagjia Bishanake, Pallati Nr.18, Hyrja Nr.6, e perfaqesuar nga administratori i pergjithshem Z.Astrit Gjikonadaj

“Shendelli” sh.p.k e regjistruar ne QKB me NIPT K07924803N me adrese Fier, Lagjja "Kastrioti", rruga "Andon Profka", 2 kullat Fier e perfaqesuar nga administratori i pergjithshem Z. Yzedin Bozh.,se oferta e paraqitur me vlerë totale prej 48 179 355 Leke ( *dyzet e tetë milion e njëqind e shtatëdhjetë e nëntë mijë e treqind e pesëdhjetë e pesë* ) lekë pa TVSH, / totali i pikëve të marra [\_\_\_\_\_] është identifikuar si fitues (paraparak) i procedurës së prokurimit.

Me publikimin e këtij njoftimi, fillojnë afatet e ankimit sipas përcaktimeve në nenin 109 të Ligjit Nr. 162/2020, datë 23.12.2020, “Për Prokurimin Publik”.

**KRYETARI I BASHKISË**

**/ Bukurosh MAÇI /**